

STATUTI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Executive Lease” Sh.p.k.

TITULLI I

Neni 1: Emërtimi, ortakët

Sot, më datë 14.04.2021 (*dymijë njezetënje*), në mbështetje të legjislacionit shqiptar, respektivisht Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, themeluesi i përcaktuar si më poshtë, ka krijuar, një Shoqëri Tregtare me emërtimin **“Executive Lease” Sh.p.k.**, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare me,

Ortak themelues:

z. Ened Matraku
z. Bjordis Koci
z. Florian Papailia

Shoqëria ka emërtimin: **“Executive Lease”**.

Shoqëria ka formën juridike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, (SHPK).

Emri Tregtar i Shoqërisë do të jetë: **“Executive Lease”**.

Shoqëria ka vulën e saj në formë rrethore me mbishkrim emërtimin e shoqërisë adresën, NIPTIN dhe numër kontakti

Neni 2: Objekti

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **“Executive Lease” Sh.p.k.**, do të zhvillojë aktivitetet me objektin e veprimtarisë si më poshtë:

- Dhenie me Qirë të Automjeteve të tonazheve të ndryshme.
- Shitblerje të Automjeteve të tonazheve të ndryshme.
- Shitblerje të Pasurive të Patundshme.
- Dhenien e ndihmes dhe konsulences për njohjen dhe shfrytëzimin e ofertave të tregjeve nderkombetare në funksion të tregut të brendshëm.
- Kryerjen e të gjithë operacioneve industriale, tregtare, mobiliare dhe imobiliare, brenda limiteve të kushteve që mund të jenë të nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të cilin është krijuar shoqëria.
- Pjesëmarrje në investimet industriale dhe tregtare, si dhe në aktivitete të ndryshme financiare, tregtare e industriale;
- Pjesëmarrja në shoqëri ekzistuese ose që do të krijohen në të ardhmen, me qëllim krijimin e subjekteve ligjore, me qëllime të njëjta apo të ngjashme.
- Përfaqësimin e shoqërive të ndryshme, shqiptare dhe të huaja, që kanë objekt të njëjtë apo të përafërt me atë të kësaj shoqërie.



- Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet imobiliare, mobiliare, tregtare, industriale, financiare apo administrative.
- Ndermjetesimi (sherbimi i brokerimit) në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve, përfshi negociatat deri në nënshkrimin e kontratave të sigurimit dhe risigurimit, në emer dhe për llogari të klienteve të Shoqërisë, me një apo me shumë shoqëri sigurimi e risigurimi.
- Sherbime Brokerimi
- Të gjitha aktivitetet e lart përmendura mund të zhvillohen si në tregun tregtar kombëtar edhe në atë nderkombëtar.
- Për realizimin e objektit dhe qëllimeve të saj shoqëria mund të ndermarre çdo lloj operacioni financiar të konsideruar si të pershtatshëm prej saj në funksion të arritjes dhe zhvillimit të aktivitetit.
- Shoqëria mund të vendosë garanci, hipotekoje në favor të ndonjë banke apo institucioni kreditues. Shoqëria mund të zhvillojë këto sherbime si direkt ashtu edhe nëpërmjet konsulentëve apo të tjerëve.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e Shoqërisë Tregtare “**Executive Lease**” Sh.p.k. është e pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 4: Selia dhe adresa elektronike

- 4.1 Selia e Shoqërisë Tregtare “**Executive Lease**” Sh.p.k. është në Rr. Zonja Curre, Pasuria. Nr 3/1216-N14. Tiranë.
- 4.2 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e R.SH., si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

TITULLI II Kapitali

Neni 5: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar “**Executive Lease**” Sh.p.k., është 2,000,000 (*Dymilion*) Lekë dhe është i ndarë në 3 (*tre*) kuota. Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.
- 5.2 Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:
- | | |
|---------------------|---|
| z. Ened Matraku | zotëron 1 kuotë me vlerë 1,200,000 Lek që përfaqëson 60 % të kapitalit themeltar. |
| z. Bjordis Koci | zotëron 1 kuotë me vlerë 600,000 Lek. që përfaqëson 30% të kapitalit themeltar |
| z. Florian Papailia | zotëron 1 kuotë me vlerë 200,000 Lek. që përfaqëson 10% të kapitalit themeltar |

Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit dhe tërheqja e kuotave të papaguara




- 6.1** Administratori mund t'u kërkojë ortakëve të paguajnë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak, në varësi të marrjes së një njoftimi prej të paktën, katërmbëdhjetë ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e veta, si përcaktohet në njoftim. Thirrja për pagesë mund të kërkojë që pagesa të bëhet me këste. Personi të cilit i drejtohet thirrja për pagesën e kontributit përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet thirrja për pagesë.
- 6.2** Zotëruesit e përbashkët të një kuote, mbajnë përgjegjësi bashkërisht dhe veçmas për të shlyer të gjitha thirrjet për pagesë të kontributit, të cilat lidhen me këtë kuotë.
- 6.3** Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratori mund t'i japë një njoftim prej jo më pak se katërmbëdhjetë ditësh të plota personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumuluar. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se nëse nuk zbatohet, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi, përgjigjen duke u anuluar.
- 6.4** Nëse njoftimi nuk zbatohet, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të bëhet pagesa e kërkuar nga njoftimi, mund të tërhiqet me vendim të Administratorit dhe tërheqja përfshin edhe të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e tërhequra dhe të papaguara deri në momentin e tërheqjes.
- 6.5** Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e tërhequr mund të shitet, të rishpërndalet ose të hiqet në bazë të kushteve dhe mënyrës që konsiderohet e arsyeshme nga administratori.
- 6.6** Personi prej të cilit janë tërhequr kuotat e kapitalit pushon së qeni ortak në lidhje me kuotat e tërhequra, por vazhdon të jetë përgjegjës përpara shoqërisë për të gjitha kontributet të cilat janë të pashlyera në datën e tërheqjes së kuotave në lidhje me këto kuota së bashku me interesin e llogaritur me normën e interesit të zbatueshëm për këto kontribute përpara tërheqjes.

Neni 7: Kuotat, të drejtat dhe kufizimet

- 7.1** Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla siç përcaktohet në vendimin e kualifikuar me 75% (*shtatëdhjetë e pese përqind*) të kapitalit të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 8: Çertifikatat e kuotave të kapitalit

- 8.1** Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një çertifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e çertifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët sipas Nenit 72, paragrafi (2) të Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët renditen në çertifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

Neni 9: Kalimi i kuotave me kontratë



- 9.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratori. Kalimi i kuotës i njoftohet selisë së regjistruar të Shoqërisë.
- 9.2 Administratori mund të mos pranojë ta regjistrojë kalimin e kuotës pranë QKR-së, nëse kuota nuk është shlyer tërësisht ose nëse nuk janë dakord që kuotën ta marrë marrësi.
- 9.3 Nëse Administratori nuk pranon ta regjistrojë kalimin e kuotës, ata, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë marrësit njoftimin për mospranimin.

Neni 10: Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit


- 10.1 Nëse një ortak vdes, bashkëzotëruesit e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotërues i vetëm ose një bashkëzotërues i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij, janë të vetmit persona, të cilët shoqëria i njej si titullarë të kuotës së tij; Por, asnjë dispozitë e këtushme, nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.
- 10.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotërues vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës tek ky person tjetër.
- 10.3 Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat, titullar i të cilave do të kishte qenë si zotërues i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.

Neni 11: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme mund ta zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% (shtatëdhjetepesë përqind) të kapitalit. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e tij në proporcion me pjesët e tyre në kapital. I njëjti vendim i kualifikuar kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.
- 11.2 Me anë të një vendimi të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75 % (shtatëdhjetepesë përqind) të kapitalit. Në rast zvogëlimi të kapitalit themeltar, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zvogëlimin e tij në proporcion me pjesët e tyre në kapital. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.

Neni 12: Blerja e kuotave nga ortakët dhe të tjerët

- 12.1 Ortakët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e pjesës që shitet përpara personave të tretë



jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim asamblesë, duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet edhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Ortaku jep ofertën brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'u transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 60 ditëve. Edhe e drejta e përparësisë, duhet t'u jepet me shkrim duke iu drejtuar asamblesë.

- 12.2** E drejta e përparësisë është proporcionale me kuotat e secilit prej ortakëve, por nëse një ortak nuk është i interesuar, tjetri mund t'i blejë kuotat që shiten.
- 12.3** Asambleja pasi ka kaluar afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij, vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve i ofrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave, duhet të bëhet me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e ortakëve.


TITULLI III Asambleja e Përgjithshme

Neni 13: Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1** Administratori mund të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme kur ta mendojë të arsyeshme vetë dhe duhet të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me Nenin 84 të Ligjit.
- 13.2** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike, që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të bëhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota kalendarike përpara mbledhjes, por kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër nëse këtë e aprovojnë shumica e ortakëve që zotërojnë jo më pak se pesëdhjetë përqind të vlerës nominale të kuotave. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.
- 13.3** Mosveprimi i paqëllimtë për dhënien e njoftimit për mbledhjen apo mos-marrja e njoftimit për mbledhjen nga personat që kanë të drejtën për ta marrë një njoftim të tillë i bën të pavlefshme punimet e mbledhjes, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 14: Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 14.1** Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të fillojnë nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në këtë statut. Ortakët ose zotëruesit e prokurave të votimit, mund të jenë të pranishëm edhe përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Nenit 88. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in, që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.



- **1¹** Asambleja e Përgjithshme e ortakëve do të konsiderohet se është mbledhur rregullisht dhe se mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave, përveç kur bëhet fjalë për rastet e parashikuara në paragrafin e mëposhtëm (**1²**).

- **1²** Asambleja e përgjithshme e ortakëve shqyrton dhe merr vendime, me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit themeltar për çështjet në vijim:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit; (75% (shtatëdhjetepesë për qind)
- c) emërimin e administratorit;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- gj) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; 75% (shtatëdhjetepesë për qind)
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; 75% (shtatëdhjetepesë për qind)
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve; 75% (shtatëdhjetepesë për qind)
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

- **1³** Asambleja e përgjithshme e ortakëve shkarkon administratorin me shumice te zakonshme votash.

- 14.2** Administratori cakton një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
- 14.3** Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohe të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.4** Me pëlqimin e mbledhjes në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhje të shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e Asamblesë. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të punës që duhen kryer. Përndryshe, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i nevojshëm.
- 14.5** Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë 1. Kryetari; ose 2. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se 5% (pesë për qind) të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë

ortaku në fjalë.

- 14.6** Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit, se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- 14.7** Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

Neni 15: Votat e ortakëve

- 15.1** Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi ka të drejtën e një vote.
- 15.2** Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë
- paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.
- 15.3** Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit, vendimi i të cilit është i formës së prerë. Të gjitha votat e pa hequra në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë janë të vlefshme.

Neni 16: Hetimet e posaçme

- 16.1** Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posaçëm sipas Nenit 91 të Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e shoqërisë të një dokumenti së bashku me një deklaratë noteriale e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

TITULLI IV
Administratori

Neni 17: Emërimi i administratorit

- 17.1** Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të vetëm të shoqërisë për 5 (pesë) vjet sipas Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 të Ligjit. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi me votën pro të shumicës së zakonshme, të kapitalit themelues, nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.
- 17.2** Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorit parashikohen në Nenin 95, paragrafi (2) i Ligjit.
- 17.3** Shoqëria do të drejtohet nga **Administratori z. Edison Hoxha**

Neni 18: Kompetencat e Administratorit

18.1 Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Neni 81 i Ligjit (6).

18.2 Administratori ka këto të drejta dhe detyrime:

- të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- të përfaqësojë shoqërinë, në mënyrë aktive ose pasive, përpara çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal, në çdo procedurë, në çdo shkallë të gjykimit, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, me të drejtën për të nënshkruar çdo akt ose dokument të nevojshëm sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse, pra, edhe me lëshimin e prokurave, mandateve të veçanta për avokatë, mbrojtës, të përgjithshme dhe për mosmarrëveshje; të lëshojnë ose të revokojnë mandate *ad lites* avokatëve dhe mbrojtësve dhe *ad negotia* punonjësve të shoqërisë ose të tretëve për një ose më shumë veprime, në kuadër të kompetencave përkatëse;
- të kryejë çdo operacion financiar dhe/ose tregtar (kontrata *leasing*; operacione cedimi kredie) aktive dhe pasive, që ka lidhje me operacione që hyjnë në objektin e shoqërisë, duke marrë përsipër angazhime dhe përmbushje të formaliteteve të nevojshme, duke përfshirë dorëzaninë,
- të çelë llogari rrjedhëse bankare, të kryejë tërheqje parash, të japë dispozita të pagesës, të firmosë çeqe që të kenë vlerë tek këto llogari rrjedhëse, edhe të zbuluar, në kufijtë e besueshmërisë së atij momenti (overcover), të verifikojë këto llogari rrjedhëse dhe të miratojë llogarinë;
- të punësojë, të pezullojë, të pushojë nga puna dhe të ndryshojë kushtet që lidhen me marrëdhënien e punës së personelit;
- të ndërveprojë me Entet e Administratës Publike për çdo negociim që lidhet me oferta, projekte, pjesëmarrje, gjithnjë brenda kufijve të parashikuar nga objekti i shoqërisë;
- të lëshojë ekstrakte të borderove dhe vërtetime që lidhen me personelin, si për entet e sigurimeve shoqërore, ashtu dhe për ente të tjera ose private; të kujdeset për respektimin e përmbushjeve, ndaj të cilave shoqëria është e detyruar, me të drejtën për të nënshkruar deklarata tatimore, që kanë lidhje me mbajtjet nga të ardhurat e punës së varur ose autonome që janë përdorur;
- të nënshkruajë deklarata fiskale në lidhje me taksat dhe tatimet në përgjithësi, si dhe çdo akt ose certifikatë të parashikuar nga legjislacioni fiskal në fuqi, të kërkojë rimbursime dhe lehtësime nga taksat dhe tatimet, të përfaqësojë shoqërinë përpara organeve të administratës fiskale dhe pranë komisioneve tatimore të çdo shkalje, me të drejtën për të emëruar mbrojtës të posaçëm;
- të përfaqësojë shoqërinë pranë organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qëllim fitimin e koncesioneve, liçencave dhe lejeve, duke emëruar, nëse është e nevojshme edhe mbrojtës të posaçëm;
- të nënshkruajë komunikimet e bankës mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit në llogari rrjedhëse dhe ekstrakteve periodike të llogarive rrjedhëse për vartësit e shoqërisë për shumat e depozituara pranë saj;
- të nënshkruajë kontrata shitblerje të mallrave dhe shërbimeve, në kufijtë e objektit të shoqërisë;
- të ndërtojë, të përfundojë dhe të administrojë marrëdhënie bankare, duke rënë dakord mbi afatet dhe kushtet;



- të kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe/ose dokumenti me qëllim depozitim e akteve dhe dokumenteve të shoqërisë pranë Gjykatës, Dhomës së Tregtisë, Zyrave Fiskale dhe Enteve të tjera;
- të përfaqësojë shoqërinë në asambljetë e shoqërive të tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe në marrëdhëniet me këto ente, organet e tyre dhe ortakët ose të asociuarit e tyre, dhe të emërojë përfaqësues, të delegojë me mandat dhe/ose prokurë, aq sa i takon kompetencave të tij.

18.3 Administratori mund t'ia delegojë kompetencat e tij komiteteve që përbëhen nga një ose më shumë anëtarë. Një delegim i tillë mund të bëhet në varësi të kushteve që mund të vendosë Administratori dhe mund të revokohet ose të ndryshohet.

18.4 Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktivë nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund t'i bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të kishin qenë të vlefshme, nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishin dhënë direktiva.

18.5 Administratori nuk mund të delegojë asnjërin prej detyrimeve, të cilat ia ngarkon ligji.

Neni 19: Skualifikimi dhe largimi i administratorit

19.1 Posti i Administratorit lirohet nëse:

1. pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë Nenin 95 paragrafi (6).
2. hyn në procedurën e paaftësisë paguese;
3. vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën Shoqërisë; ose
5. ka munguar për më shumë se tre muaj radhazi pa leje në aktivitetin e përditshëm të shoqërisë ose Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Ortakëve të tjerë vendos ta lirojë nga detyra.

Neni 20: Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorit

20.1 Administratori ka të drejtë të marrë shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.

20.2 Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime, në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata persona të cilët kanë punuar më parë për shoqërinë ose për shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë filiale të shoqërisë ose për shoqëri pararendëse të shoqërisë ekzistuese, ose për familjarë të tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish-bashkëshortin ose ish-bashkëshorten) ose për persona të cilët janë në varësi të tyre, dhe mund të japë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla (si përpara ashtu dhe pasi personi në fjalë pushon së mbajturi postin ose marrëdhënien e punës).

Neni 21: Vendimet e Mbledhjeve të Administratorit

21.1 Mbledhjet e Administratorit mbahen sa herë ta kërkojë aktiviteti i shoqërisë.

21.2 Të gjitha aktet e kryera nga Administratori ose nga një person që ushtron detyrën e caktuar nga Administratori, pavarësisht faktit nëse më vonë zbulohet se ka pasur mangësi në emërimin e tij ose ka qenë i skualifikuar nga e drejta për të mbajtur detyrën ose nuk ka pasur të drejtë vote,

janë të vlefshëm njësoj sikur të gjithë këta persona të ishin emëruar rregullisht, të plotësonin kushtet, të vazhdonin të ishin Administratorë.

Neni 22: Kufizimet për votimin

- 22.1** Një Administrator nuk lidh asnjë marrëveshje dhe nuk merr vendime për asnjë çështje në të cilën ka, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, një interes ose detyrë me rëndësi materiale dhe që bie ose mund të bjerë ndesh me interesat e shoqërisë sipas nenit 13 të Ligjit, nëse me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nuk kanë rënë dakord:
1. të autorizojnë lidhjen e marrëveshjes nga ana e tij dhe,
 2. ta autorizojnë të vendosë për çështjen në fjalë.
- 22.2** Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të veçantë. Çdo aprovim i përgjithshëm duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).
- 22.3** Një Administrator nuk konsiderohet si pjesëtar i kuoromit të pranishëm në një mbledhje në lidhje me një vendim për të cilin nuk ka të drejtë vote. Për përjashtimin e Administratorit nga marrja e vendimit në një mbledhje të tillë zakonisht zbatohet përkatësisht Neni 89 i Ligjit.

Neni 23: Procesverbalet e mbledhjeve të Administratorit

- 23.1** Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbajë procesverbalet e të gjitha takimeve të bëra nga Administratori.
- 23.2** Të të gjitha punimeve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe mbledhjeve të Administratorit dhe të komiteteve të krijuara nga Administratori, përfshirë edhe emrat e personave të ftuar të pranishëm në këto mbledhje.

KAPITULLI V
Dividendët dhe kapitalizmi i fitimeve

Neni 24: Dividendët

- 24.1** Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividendë në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 24.2** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend, duke filluar nga një datë e caktuar atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.
- 24.3** Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.
- 24.4** Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet



pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është e detyruar ta paguajë.

Neni 25: Kapitalizimi i fitimeve

25.1 Me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga Neni 14 i Ligjit, Administratorët mund të vendosin të kapitalizojnë fitimet e pashpërndara të shoqërisë që nuk kërkohen për të paguar dividende preferenciale ose borxhe të tjera të pashlyera ende nga shoqëria dhe kapitali i detyruar i shoqërisë.

**TITULLI IV
Prishja dhe Njoftimet**

Neni 26: Prishja dhe Likuidimi

26.1 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesit me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'i shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

Neni 27: Njoftimet

27.1 Njoftimet që i jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit, duhet të jenë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në Nenin 4, paragrafi (8) të këtij statuti që është i vlefshëm në momentin që i bëhet e ditur për këtë qëllim personit që bëri njoftimin.

27.2 Shoqëria mund t'i japë një njoftim një ortaku ose personalisht ose duke ia nisur me poste në një zarf për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut ose duke ia lënë në këtë adresë ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut. Kur ka bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve në përputhje me Nenin 7, paragrafin (2) të Ligjit.

27.3 Në këtë statut, përfshihen shtesa dhe ndryshime dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikatat dhe procesverbalet e shoqërisë, vendosen nga Administratori në hapësirën në internet të shoqërisë të parashikuar në Nenin 4, paragrafi (2) i këtij Statuti.

Neni 28: Dispozita të përgjithshme

28.1 Për sa i përket çështjeve që nuk janë parashikuar nga ky statut, do të aplikohen dispozitat e Shoqërive me Përgjegjësi të kufizuar sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

28.2 Selia e shoqërisë duhet të ketë të mbishkruar pas kësaj të paktën emrin e shoqërisë, numrin e vendimit dhe vitin e inkorporimit dhe fjalët "Vula e shoqërisë".

28.3 Çdo mosmarrëveshje që del nga kjo marrëveshje do të caktohet para gjykatës së vendit, ku ndodhet zyra e regjistruar e shoqërisë.



Neni 29: Dispozita përfundimtare

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) ekzemplarë origjinalë, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, njëri prej të cilëve do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Statuti mbyllet me 29 (njëzet e nëntë) nene. Ky Statut do të hyjë në fuqi menjëherë me regjistrimin e tij në QKB.

Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

ORTAKËT

e

Shoqërisë Tregtare "Executive Lease" Sh.p.k.


Ened Matraku




Bjordis Koci



Florian Papailia



